

# **Raportimi i medias mbi Reformën në Drejtësi**

*Periudha e monitorimit: Korrik-Shtator 2019*

Ky raport u hartua nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadrin e projektit “Fuqizimi i rolit të medias së pavarur në procesin e reformës në drejtësi në Shqipëri,” i mundësuar nga ‘Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën’, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

## **RAPORTIMI I MEDIAS MBI REFORMËN NË DREJTËSI, KORRIK-SHTATOR 2019**

Përzgjedhja e kampionit në këtë tremujor është bërë e tillë për të përfshirë qëndrimet mbizotëruese mbi Reformën në Drejtësi, duke marrë në konsideratë edhe periudhën nën monitorim, si dhe zhvillimet e forta politike gjatë fillimit të tremujorit të tretë.

Kështu, këtë tremujor janë përzgjedhur për t'u monitoruar edicionet qendrore të lajmeve të “A2 CNN” dhe “Vizion Plus”, ndërsa nga shtypi janë monitoruar “Gazeta Shqiptare” dhe gazeta “DITA”. Nga mediat online u përzgjedhën si kampion “Shqip Online” dhe “Lapsi.al”.

Monitorimi është bërë duke u fokusuar te lajmet për Reformën në Drejtësi në përgjithësi, si dhe specifikisht te zhvillimet mbi vettingun dhe ngritjen apo funksionimin e KLP/ KLGJ/ SPAK.

Në portale janë monitoruar çdo ditë, përgjatë tre muajve rubrikat “Aktualitet/ Politikë” te “Lapsi.al” dhe “Shqip Online”, ku edhe është konstatuar se janë klasifikuar lajmet mbi Reformën në Drejtësi. Fillimisht janë identifikuar të gjitha publikimet mbi Reformën në Drejtësi në përgjithësi duke i nëngrupuar më pas në lajme mbi vettingun apo mbi KLP/KLGJ/SPAK (Shiko grafikët).

Në përfundim të monitorimit është bërë një vlerësim cilësor dhe statistikor i përmbajtjes. Pas zbulimit të numrit total të lajmeve në rubrikat përkatëse dhe numrit total të lajmeve mbi Reformën në Drejtësi është nxjerrë në përqindje edhe vendi që zënë publikimet mbi reformën në tërësinë e lajmeve të nxjerra në rubrikat në fjalë.

Ndryshe nga si është vepruar herën e fundit, ku për gazetat dhe televizionet janë përzgjedhur si kampion 45 numra apo edicione lajmesh, këtë tremujor janë monitoruar të gjithë numrat si edhe edicionet e lajmeve. Kjo është bërë për të shmangur devijimet e mundshme për shkak se periudha e monitoruar përkon me pushimet vjetore.

Kështu, gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 90 numra të gazetave “Gazeta Shqiptare” dhe “DITA” si edhe 90 edicione qendrore të lajmeve të “A2 CNN” dhe “Vizion Plus” gjatë periudhës 1 korrik-30 shtator.

Në fund është bërë një vlerësim statistikor dhe cilësor i raportimeve mbi zhvillime të rëndësishme, siç janë ngritja e SPAK apo rivlerësimi i emrave të rëndësishëm në Sistemin e Drejtësisë.

# 1. PASQYRË E GJETJEVE STATISTIKORE

## 1.1. Televizionet


Pas një muaji me zhvillime të nxehta politike, raportimi i të cilave ka zënë deri diku vendin e informacioneve mbi Reformën në Drejtësi (shiko raportin e periudhës prill-qershor), në korrik rifillon rutina me intervistimin e kandidatëve për SPAK-un dhe përcaktimi i kandidaturave për Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë.

Nga monitorimi rezulton se redaksia e lajmeve të A2 CNN është më e fokusuar te raportimi i zhvillimeve mbi Reformën në Drejtësi krahasuar me Vizion Plus, gjë që konfirmohet nga numri i kronikave, përmbajtja e tyre dhe kohëzgjatja totale.

Gjatë periudhës nën monitorim, në A2 CNN janë transmetuar 64 kronika mbi Reformën në Drejtësi në përgjithësi, si dhe për institucionet që lidhen me të, krahasuar me 49 kronika të transmetuara nga Vizion Plus. Totali i kronikave mbi Reformën në Drejtësi të transmetuara nga A2 CNN është 128 minuta, ndërsa kohëzgjatja totale e kronikave për këtë çështje në Vizion Plus është 74 minuta.

Krahas kronikave, A2 CNN i ka mbuluar ngjarjet përgjithësisht edhe përmes raportimeve direkt të gazetarëve apo lidhjeve direkt me gazetarë nga newsroom-i, ndërkohë që Vizion Plus është vërejtur të raportojë në një pjesë të mirë të rasteve me mbulim, ku spikeri lexon në studio informacionin, teksa regjia fut plane që kanë të bëjnë direkt me ngjarjen apo nga arkiva.

Ndryshe nga ajo që kemi hasur gjatë monitorimit në tremujorin e parë, e reflektuar edhe gjatë tremujorit të dytë, në periudhën aktuale vërehet një shmangie e raportimeve mbi aktivitetin e përditshëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), duke u fokusuar tek aktiviteti i institucioneve të tjera si Kolegji i Lartë i Prokurorisë (KLP), Kolegji i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe SPAK-u.



**Figurë 1 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në televizionet "A2 CNN" dhe "Vizion Plus" gjatë periudhës korrik-shtator 2019**

Kjo vjen edhe si rrjedhojë e intensifikimit të punës për bërjen e SPAK-ut funksional, dhe prej funksionimit normal të KLGJ dhe KLP për shkak se gjatë periudhave të mëparshme KPK ka vlerësuar si kalues gjykatës dhe prokurorë, të cilët më pas është dashur që të emërohen.

Kështu, nga 64 raportime të A2 CNN mbi çështje që kanë të bëjnë me reformën, vetëm 19 prej tyre lidhen me KPK dhe pjesa tjetër kanë të bëjnë kryesisht me KLGJ, KLP dhe sidomos SPAK.

E njëjta panoramë vërehet edhe te Vizion Plus, ku nga 49 lajme mbi reformën, 33 prej tyre lidhen me KLGJ, KLP dhe SPAK, kurse 16 me vendimet e KPK apo reagime që kanë të bëjnë me to.

## **1.2. Shtypi i shkruar**

Diferenca e theksuar në mbulimin e zhvillimeve në Reformën në Drejtësi gjatë monitorimit në tremujorin e dytë nuk konstatohet në këtë tremujor.

Në këtë tremujor rezulton se si “Gazeta Shqiptare”, ashtu edhe “Dita” të kenë botuar mesatarisht gjysmë faqe në ditë lajme mbi reformën apo institucionet që lidhen me të.

Nga monitorimi konstatohet se gjatë periudhës korrik-shtator, gazeta “Dita” të ketë botuar një total prej 1589 lajmesh në rubrikën politikë/ aktualitet. Nga këto, 52 lajme janë për reformën në tërësi me një ndarje respektive, 42 për KLP/ KLGJ/ SPAK dhe 11 prej tyre për vettingun.


Në tregues të ngjashëm konstatohet të jetë edhe “Gazeta Shqiptare”, e cila gjatë periudhës nën monitorim ka botuar gjithsej 1528 lajme në rubrikën aktualitet/ politikë, nga të cilat 30 kanë të bëjnë me KLP/ KLGJ/ SPAK, dhe 12 prej tyre për vettingun me një total prej 42 lajmesh mbi reformën.

Diferenca e ngushtë mes dy mediave të printuara në raportimin e lajmeve tregon edhe filtrin e përdorur prej tyre për të botuar vetëm ato lajme të vlerësuara se përbëjnë interes publik në raport me morinë e zhvillimeve të përditshme që kanë të bëjnë me reformën.

Rezulton se te “Dita”, 3.2 për qind e totalit të lajmeve të botuara në rubrikat nën monitorim kanë të bëjnë me reformën apo zhvillime që lidhen me të, ndërkohë që te “Gazeta Shqiptare” raporti lajme totale në aktualitet dhe politikë/ lajme mbi reformën është 2.74 për qind.

Nga 52 publikime mbi reformën, 6 prej tyre ose 11.5 për qind janë pasqyruar në faqen e parë te “Dita”, ndërsa te “Gazeta Shqiptare”, nga 42 lajme mbi reformën, 6 prej tyre ose 14.3 për qind kanë gjetur hapësirë në faqen e parë.


Te “Gazeta Shqiptare”, lajmet mbi Reformën në Drejtësi janë publikuar kryesisht në faqet 5-6-7 në varësi të zhvillimit, ndërkohë që te “Dita” vërehet një shpërndarje më e madhe. Kjo shpërndarje vjen për shkak të natyrës së ndryshme që kjo gazetë përdor për të ofruar informacionin.



**Figurë 2 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në "Gazeta Shqiptare" gjatë periudhës korrik-shtator 2019**

“Dita”, në pjesën më të madhe të rasteve vendos një tematikë të caktuar në fokus dhe informacioni në të gjitha faqet e tjera shpërndahet në varësi të hapësirës që zë tema ditore. Kjo shpjegon dhe faktin se përse një lajm mbi reformën mund ta gesh në faqen e fillimit dhe një ditë më pas gjendet në faqet e fundit të gazetës.

“Gazeta Shqiptare” raporton me lajme të gjata të shoqëruara me lajme më të shkurtra në shërbim të shterimit të temës kryesore, ndërsa “Dita” bën një raportim më të copëzuar, kryesisht me shkrime të shkurtra në faqet e aktualitetit dhe politikës. Kjo vërehet kryesisht në lajmet mbi vendimet e KPK-së. Është pikërisht kjo qasje që shpjegon një numër disi më të lartë të lajmeve mbi reformën të “Dita”, ndërkohë që “Gazeta Shqiptare” konstatohet të ketë një diferencë të vogël në hapësirë fizike në faqe për këto lajme.



**Figurë 3 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në gazeta "DITA" gjatë periudhës korrik-shtator 2019**

Në disa raste është vërejtur që “Dita” të ketë mbajtur qëndrim editorial për çështje të caktuara mbi reformën apo gjyqtarë/ prokurorë të caktuar, ndryshe nga “Gazeta Shqiptare”, e cila i ofrohet lexuesit përmes opinioneve të të tjerëve.

Nga monitorimi konstatohet një qëndrim pozitiv i të dyja gazetave mbi reformën në përgjithësi duke nxitur përshpejtimin e saj, ndërsa herë pas here vërehen pikëpyetje mbi efektivitetin e procesit të vettingut për shkak të vendimeve për prokurorë apo gjyqtarë të caktuar nga KPK.

### 1.3. Portalet

Hapësira online i bën portalet që të jenë më fleksibël sa i përket raportimit në përgjithësi pasi ndryshe nga shtypi i shkruar apo ai audioviziv nuk janë të kushtëzuara nga faqet apo sekondat. Jo rastësisht, ndryshe nga televizionet dhe shtypi i shkruar, gjatë monitorimit të portaleve janë konstatuar një numër i madh lajmesh me burim nga partitë politike, të cilat më shumë se sa prej qëndrimeve editoriale të tyre vijnë për shkak se mediat online kanë luajtur rolin e një platforme ku mbështetësit apo kundërshtarët e Reformës në Drejtësi janë përplasur me njëri-tjetrin.




Në ditë të ndezura të debatit politik që lidhet me zhvillimet mbi reformën janë hasur mjaft publikime mbi reagime dhe kundër-reagime të partive të ndryshme politike.

Shembulli tipik i kësaj situatë janë datat 3-4 korrik ku si te “Shqip Online” ashtu edhe te “Lapsi.al” konstatohet një numër i madh lajmesh mbi debatin në distancë mes Presidentit të Republikës Ilir Meta dhe ministrave të caktuar të qeverisë mbi reformën. Përveç akuzave që palët i bëjnë njëra-tjetrës në publikim nuk gjendet asnjë informacion tjetër shtesë që të shpjegojë se përse po bëhet reforma, institucionet e reja apo edhe elementet teknike që lidhen me arsyen se përse palët po shkëmbejnë akuzat.

Fokusi konstatohet të jetë vetëm tek ajo që palët e përfshira thonë, ndërsa karakteristikë e këtyre lajmeve është hyrja e shkurtër, citimi i gjatë dhe mungesa e kontekstit në pjesën më të madhe të rasteve.

Nga monitorimi është vërejtur se “Shqip Online” ka publikuar një numër më të madh lajmesh mbi reformën në përgjithësi apo zhvillimet që kanë të bëjnë me të, krahasuar me “Lapsi.al”.

Nga analizimi i përmbajtjes konstatohet se kjo diferencë nuk vjen për shkak të qëndrimeve editoriale, por nga formati që këto portale kanë zgjedhur. Lapsi është më tepër i fokusuar te lajmi i gjatë dhe analitik, për rrjedhojë bëhen më pak postime, ndërsa “Shqip” bën një gërshetim mes investigimit dhe lajmit “flash”, gjë e cila pasqyrohet edhe në statistika.




**Figurë 4 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në "Shqip Online" gjatë periudhës korrik-shtator 2019**

Gjatë periudhës së monitoruar, “Lapsi” ka publikuar gjithsej 98 lajme, ndërkohë që “Shqip” ka publikuar 151 lajme.

Një pjesë e mirë e lajmeve të publikuara nga “Shqip Online” kanë të bëjnë me aktivitetin e KPK-së. Portali bën një mbulim të plotë të tyre duke raportuar thuajse çdo intervistim të gjyqtarëve apo prokurorëve, si dhe raportet e publikuara nga këto komisione.

Ndryshe nga “Shqip Online”, “Lapsi.al” raporton kryesisht për emra të njohur të sistemit të drejtësisë që kalojnë në sitën e vettingut, duke i shoqëruar publikimet e tij edhe me raporte mbi pasurinë me burime kryesisht nga BIRN. Kjo media vërehet të jetë burimi i parë edhe i “Shqip Online”, në rastet kur raportohet mbi pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që vlerësohen nga KPK.



**Figurë 5 - Pasqyrë statistikore e gjetjeve në "Lapsi.al" gjatë periudhës korrik-shtator 2019**

Gjatë periudhës së monitoruar konstatohet se “Shqip Online” ka bërë mesatarisht 2-3 publikime në ditë për çështje që kanë të bëjnë me reformën krahasuar me mesataren 1-2 publikime në ditë të “Lapsi.al”.

Raportimi i mediave online mbi reformën është kryesisht spontan, pa një agjendë paraprake, duke u ndikuar nga zhvillimet ditore dhe jo nga planifikimi i redaksisë për të ndjekur tematika të caktuara. Kjo shpjegon edhe ndryshimet e theksuara të numrit të publikimeve nga dita në ditë.

Shembulli më kuptimplotë i kësaj dukurie janë datat 16-17 korrik. Në datën 16 korrik “Shqip Online” dhe “Lapsi.al” kanë një numër rekord publikimesh mbi reformën, përkatësisht 6 dhe 5 të tilla. Bëhet fjalë për ditën kur u miratua lista e kandidatëve për SPAK-un. Ky ritëm i lartë nuk ndiqet një ditë më pas, ku secila prej mediave ka një numër minimal lajmesh, vetëm 1 të tillë.

Nga analiza e përmbajtjes konstatohet se të dyja mediat mbështesin reformën, por ndryshe nga “Shqip”, “Lapsi.al” është më skeptik në lidhje me procese të caktuara të reformës siç është mënyra se si u hartua ajo, apo ngritja e institucioneve kryesore që përbëjnë reformën në vetvete.

## **2. ÇËSHTJET KRYESORE DHE PROBLEMATIKAT**

### **2.1. SPAK-u dhe mitet që shoqërojnë ngritjen e tij**

Ngritja e SPAK është një ndër ngjarjet më të mbuluara në mediat që janë monitoruar gjatë tremujorit të tretë, vëmendje që krahasohet me hapat e parë të reformës, si dhe ngritjen e institucioneve të tjera si KLGJ apo KLP.

Kjo vëmendje ndaj SPAK-ut lidhet edhe me fushën e veprimit të këtij institucioni të ri në kuadër të Reformës në Drejtësi, ku perceptimi i përgjithshëm është se njësia do të hetojë dhe burgosë zyrtarët e lartë të vendit. Kuriozitetit i shtohet edhe nevoja për të parë më në fund drejtësinë që të funksionojë edhe mbi të pushtetshmit, çka i bën lajmet mbi SPAK-un të shihen me interes nga audienca.

Pavarësisht ngjarjeve të rënda, siç ishte një krim në Kavajë, apo problematikave që dolën pas zgjedhjeve të kontestuara të 30 qershorit, ngritja e SPAK-ut zë një hapësirë të gjerë në mediat e monitoruara.

Në edicionin e lajmeve të datës 3 korrik, A2 CNN<sup>1</sup> transmeton një kronikë ku i referohet deklaratës së shefes së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, zonjës Cavalera, e cila shprehet se pret të shohë njerëz pas hekurave në fund të procesit duke iu referuar reformës në përgjithësi, dhe SPAK-ut në veçanti. Deklarata e Cavalera-s gjen të nesërmen pasqyrim edhe te mediat print si edhe “Shqip Online”<sup>2</sup>. Media në fjalë është fokusuar në deklaratat e saj ndaj

---

<sup>1</sup> [https://www.youtube.com/watch?v=18h3Sxp\\_7YY](https://www.youtube.com/watch?v=18h3Sxp_7YY)

<sup>2</sup> <https://www.gazeta-shqip.com/2019/07/04/kapni-kohen-e-humbur-shefja-e-misionit-nderkombetar-per-reformen-ne-drejttesi-i-pergijgjet-ashper-presidentit-meta/>

Presidentit Meta, më shumë se sa te mesazhet për të rekuperuar kohën e humbur deri më tani me implementimin e reformës.

Një ditë më vonë “Shqip Online” raporton mbi procesin e intervistimit të kandidatëve për SPAK-un, duke publikuar edhe disa pyetje që KLP do t'i bëjë atyre “për dosje të caktuara, me emra të pandehurish, apo ato që lidhen me persona të caktuar dhe numra dosjesh me objekt sekret hetimi”<sup>3</sup>.

Lapsi.al raporton gjithashtu mbi fillimin e intervistave për prokurorët që pretendojnë të jenë pjesë e SPAK-ut, duke dhënë edhe detaje në lidhje me kandidatë të caktuar, si dhe fushën e veprimit që do të ketë njësia e re<sup>4</sup>. Një ditë më vonë portali shtron një problem të mprehtë që kompromenton reformën, siç është mosdalja nga sistemi e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët edhe pse janë përjashtuar nga detyra me vendim të KPK, vijojnë aktivitetin e tyre, tashmë si avokatë<sup>5</sup>.

Më datë 8 korrik, Vizion Plus raportoi mbi intervistimin e pesë gjyqtarëve kandidatë për SPAK<sup>6</sup>. Një ditë më pas televizioni i rikthehet sërish kësaj teme duke raportuar se dy prokurorë të njohur synojnë gjithashtu të bëhen pjesë e SPAK<sup>7</sup>.

Rezulton se gjatë periudhës 1-15 korrik, edhe pse përkon me fillimin e sezonit të pushimeve apo gjendemi fill pas zgjedhjeve të kontestuara të 30 qershorit, në mediat e monitoruara janë publikuar gjithsej 32 lajme vetëm për SPAK-un apo zhvillime që kanë të bëjnë me të. Ndërkohë, deri në fund të korrikut, vetëm te “Dita” janë konstatuar 8 lajme dhe 2 opinione në lidhje me SPAK. Në tërësi ky konsiderohet një numër relativisht i lartë krahasuar me institucionet e tjera, por edhe duke marrë në konsideratë periudhën.

---


<sup>3</sup> <https://www.gazeta-shqip.com/2019/07/05/vendim-surprize-kush-tregon-per-intervistat-sekrete-me-prokuroret-e-spak/>

<sup>4</sup> <https://lapsi.al/2019/07/05/ngritja-e-spak-4-emrat-e-pare-intervistohen-te-henen/>

<sup>5</sup> <https://lapsi.al/2019/07/06/te-shkarkuarit-nga-vettingu-jane-ende-pjese-e-sistemit-te-drejtise-ushtrojne-avokatine/>

<sup>6</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=A6ezC587j20>

<sup>7</sup> [https://www.youtube.com/watch?v=Iw\\_QJhbo2zo](https://www.youtube.com/watch?v=Iw_QJhbo2zo)



**Figurë 6 - Sa herë është përdorur termi "SPAK" në titull lajmi gjatë periudhës korrik-shtator 2019 në mediat e monitoruara**

Gjatë periudhës nën monitorim është konstatuar gjithashtu pasqyrimi i gjerë i dy intervistave të kreut të KLP-së, dhënë në korrik për “Deutsche Welle”, ku shpjegon se si do të funksionojë SPAK si dhe një tjetër dhënë në 2 shtator për News 24 ku tregon se ngritja e kësaj njësie pritet të ndodhë në një kohë të shkurtër. Të dyja intervistat janë botuar nga “Lapsi.al”<sup>8</sup> dhe “Shqip Online”<sup>9</sup>

SPAK-u rezulton të jetë një term gjerësisht i përdorur nga “Dita”. Gjatë tremujorit të tretë, në këtë gazetë është konstatuar 14 herë përdorimi i fjalës “SPAK” në titull. Ndërkohë te “Gazeta Shqiptare” konstatohet se fjala “SPAK” është përdorur 9 herë në titull.

Te “Shqip Online” fjala “SPAK” është konstatuar 33 herë, ndërsa te “Lapsi.al” është përdorur 17 herë. Sa i përket televizioneve, A2 CNN ka transmetuar 19 kronika, duke e përmendur SPAK-un në titull krahasuar me 6 kronika të Vizion Plus.

<sup>8</sup> <https://lapsi.al/2019/09/02/ngritja-e-spak-gent-ibrahimi-jemi-prane-finalizimit-ctare-synojme/>

<sup>9</sup> <https://www.gazeta-shqip.com/2019/09/02/spak-gati-te-veproje-pas-vettingut-edhe-per-disa-prokurore/>  
<https://www.gazeta-shqip.com/2019/09/02/spak-gati-te-veproje-pas-vettingut-edhe-per-disa-prokurore/>

## 2.2. Besim Hajdarmataj ose “prokurori që donte të burgoste ministrin”

Besim Hajdarmataj u bë i njohur për publikun pasi ishte një ndër tre prokurorët e Krimeve të Rënda që pati në dorë dosjen e një ministri. Kjo bëri që të vihej në shënjestër të mediave që shihen si më pranë qeverisë, ndërkohë që u bë heroi i mediave që shihen si më pranë opozitës. Që prej asaj periudhe, karriera e Hajdarmatajt, i njohur në zhargonin mediatik edhe si “prokurori i dosjeve të nxehta” ka ngjallur vazhdimisht kuriozitet. Ky fakt konstatohet dhe gjatë monitorimit ku edhe pse ishte njëri ndër 22 prokurorët që u intervistuan nga KLP për të qenë ose jo pjesë e SPAK-ut, emri i tij u lakua më shumë se kolegët e tjerë, shpesh me ngarkesa politike.

“Shqip”<sup>10</sup> publikon më datë 9 korrik shkrimin me titull: “Ngritja e SPAK/ Kontrollohen 4 prokurorë, ‘shërbëtori famekeq i Saliut’ pyetet për përgjimet e BILD”. Në shkrim, Hajdarmataj portretizohet si prokuror në shërbim të ish-liderit të opozitës duke aluduar se ishte ai që shpërndau përgjimet e dosjes “339” të publikuara më pas në gazetën gjermane “Bild”.

Prokurori në fjalë gjendet i veçuar nga kolegët e tij që u intervistuan edhe te “Lapsi.al” në të njëjtën datë ku theksohet se është pyetur për daljen e përgjimeve<sup>11</sup>.

Paraqitja e tij para KLP-së duke kandiduar për SPAK-un ka gjetur pasqyrim edhe në edicionet qendrore të lajmeve të datës 9 korrik të dy televizioneve, si dhe në numrat e datës 10 korrik të gazetave të monitoruara.

Mediat e kanë raportuar me të njëjtën optikë edhe lajmin se Hajdarmataj nuk u kualifikua në garën për SPAK duke e veçuar emrin e tij, edhe pse bashkë me të gjendeshin edhe shtatë kolegë të tjerë, të cilët gjithashtu u shkualifikuan nga KLP. Kështu për shembull, kronika e transmetuar nga Vizion Plus më datë 16 korrik titullohet: KLP “djeg” Prelën dhe Hajdaramatajn/ Ja 15 prokurorët kandidatë për SPAK<sup>12</sup>.

---

<sup>10</sup> <https://www.gazeta-shqip.com/2019/07/09/ngritja-e-spak-kontrollohen-4-prokurore-sherbetori-famekeq-i-saliut-pyetet-per-pergjimet-e-bild/>

<sup>11</sup> <https://lapsi.al/2019/07/09/hajdarmataj-nen-filtrin-e-spak-pyetet-per-dosjet-e-nxehta-339-dhe-184/>

<sup>12</sup> <https://www.vizionplus.tv/klp-djeg-prelen-dhe-hajdaramatajn-ja-15-prokuroret-kandidate-per-spak/>

### 2.3. Reforma, mes skepticizmit dhe nevojës për rezultate të shpejta

Me fillimin e punës së institucioneve të reja në kuadër të Reformës në Drejtësi siç janë KPK, KLP dhe KLGJ, krahasuar me dy tremujorët e mëparshëm vërehet një nivel më i ulët skepticizmi, që duket të jetë zëvendësuar me nevojën për të parë rezultate në një periudhë kohore sa më të afërt.

Duke qenë se ndryshimet e mëdha në Sistemin e Drejtësisë janë konstatuar si një reformë që do të burgosë zyrtarë te niveleve të larta, jo rastësisht SPAK-u është njësi ku zhvillimet shoqërohen me interes të lartë të medias dhe shoqërisë.

Megjithatë, ky proces vijon të shoqërohet me skepticizëm në lidhje me efektivitetin dhe funksionimin e mirëfilltë të këtyre institucioneve. “Dita” e datës 3 shtator shkruan se SPAK-u është i mangët sepse nuk ka kandidatë për prokurorë që përmbushin kushtet e vendosura për të qenë pjesë e kësaj njësie. Një ditë më parë, gazeta ka publikuar shkrimin: “Drejtësi e re me drejtues të vjetër”, ku theksohet se institucionet e reja të drejtësisë kanë në krye personazhe të njohur të periudhës së mëparshme.

Ndër të tjera, duke iu referuar një raporti të Institutit të Studimeve Politike, gazeta shkruan: “Rreth 60 për qind e kandidatëve janë ish-prokurorë të përgjithshëm, ish-kryetarë të gjykatës së lartë, ish-ministra drejtësie, ish-drejtues në nivele të larta të gjyqësorit apo prokurorisë, etj. Një pjesë e tyre e kanë mbyllur mandatin e parë (ish) me një bilanc kritik dhe negativ publik, ndaj kurajoja e tyre për të pretenduar edhe postet e reja drejtuese në sistemin e ri të drejtësisë përbën një fenomen që meriton analizë”<sup>\*</sup>.

Ndërkohë, krahas raportimit të procesit të kualifikimit të kandidatëve për SPAK-un, si dhe të procesit të ngritjes dhe funksionimit të tij, “Vizion Plus” raporton në edicionin qendror të lajmeve të datës 21 korrik se kjo njësi do të fillojë punën në vjeshtë dhe se zyrtari i parë që do të bjerë në “rrjetë” pritet të jetë një ish-kryeprokuror<sup>13</sup>.

Në korrik u bënë tre vjet që kur Kuvendi miratoi ndryshimet thelbësore në Kushtetutë që do të mundësonin kryerjen e reformës. Duke theksuar se u bënë tre vjet që nga ai moment, “Dita” e datës 23 korrik shtron pyetjen: “Edhe sa kohë do të duhet për t’u përmbyllur

---

\* Gazeta Dita, 3 shtator 2019.

<sup>13</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=RCFegllTmhU>

reforma?” Shkrimi shoqërohet edhe me statistika ku bie në sy numri i madh i prokurorëve dhe gjyqtarëve që pritet t’i nënshtrohen vettingut. Kjo sipas gazetës do të bëjë që implementimi i plotë i reformës të kërkojë kohë.

#### **2.4. Raportimi përmes dosjeve të nxehta që kanë patur prokurorët dhe gjyqtarët**

Prokurori i Krimeve të Rënda Gentian Osmani ishte një ndër emrat më të lakuar gjatë tremujorit të tretë në mediat e monitoruara për shkak të shkarkimit të tij fillimisht nga KPK dhe konfirmimit të këtij vendimi nga KPA. Osmani nuk u kualifikua për të vijuar në Sistemin e Drejtësisë, pasi sipas KPK-së nuk justifikonte shpenzimet gjatë viteve 2011-2013. Megjithatë, siç vërehet edhe nga monitorimi, lajmet për rishqyrtimin e emrit të tij nga KPA janë shoqëruar në pjesën më të madhe të rasteve me faktin se ai ishte “njëri ndër prokurorët që kërkoi burg për një ish-ministër”<sup>14</sup>. Edhe “Gazeta Shqiptare” e datës 1 gusht e njofton shkarkimin e ish-prokurorit me titullin: “KPA shkarkon prokurorin Gentian Osmani, që kërkoi arrestimin e Saimir Tahirit”.

Lajmi gjithashtu gjen pasqyrim edhe te “Shqip Online”<sup>15</sup>, edicionet qendrore të lajmeve të “A2 CNN”<sup>16</sup> dhe “Vizion Plus”<sup>17</sup>, ndërsa fakti që ai ka qenë pjesë e treshes së prokurorëve që kërkuan arrestimin e një ish-ministri nuk përmendet në titull, por kalohet si pjesë e background-it të lajmit në tekst.

“A2 CNN” e raporton lajmin me titullin: “‘Digjet’ Osmani i KLP”, ndërkohë që fill pas kronikës diskutohet me të ftuarin në studio, ndërsa “Vizion Plus” e raporton me titullin: “Shkarkohet Gentian Osmani”. Gjatë kronikës me mbulim, televizioni përdor plane të një ish-ministri duke shkuar në gjykatë, si dhe momentet kur ai ndodhej para treshes së prokurorëve, pjesë e së cilës ishte edhe prokurori në fjalë.

Asociimi i prokurorëve apo gjykatësve me dosjet e rëndësishme që ata kanë patur në duar është një fenomen që vërehet shpesh në raportimin e mediave gjatë procesit të vettingut apo intervistave të tjera në shërbim të të qenit pjesë e institucioneve të reja. Me një qasje të njëjtë

---

<sup>14</sup> <https://lapsi.al/2019/07/11/vettingu-prokurori-i-dosjes-tahiri-perballet-ne-kpa-me-kerkesen-per-shkarkim/>

<sup>15</sup> <https://www.gazeta-shqip.com/2019/07/31/vendimi-final-i-vettingut-prokurori-gentian-osmani-perjashtohet-nga-sistemi-i-drejtetise/>

<sup>16</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=SMpuyHdzoD0>

<sup>17</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=pFwOgJPrbkY>



është raportuar edhe për dy anëtarët e tjerë të trupës së prokurorëve që hartuan dosjen për një ish-ministër.

## **PËRFUNDIME**

Tremujori i tretë, periudhë në të cilën është kryer monitorimi karakterizohet nga zhvillime të rëndësishme, siç janë finalizimi i procesit të ngritjes së SPAK-ut, apo të zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë. Kjo ka bërë që lajmet mbi reformën apo zhvillime që kanë të bëjnë me të, të hasen më shpesh në media.

Nga monitorimi konstatohet një qasje pozitive e medias në lidhje me domosdoshmërinë e kryerjes së Reformës në Drejtësi në vend, madje në disa prej tyre parashtrohet shqetësimi se përse procesi i vettingut po vijon jo sipas ritmeve të parashikuara duke bërë që KLP, madje edhe KLGJ të “qeverisin” përmes emërimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve të përkohshëm.

Ky shqetësim vërehet gjatë muajit korrik ku theksohet se tashmë janë bërë tre vjet që nga momenti kur Kuvendi miratoi ndryshimet Kushtetuese duke bërë të fillojë Reforma në Drejtësi, ndërsa duhet ende kohë për të parë rezultate të prekshme.

Vlen të theksohet fakti se vendime të caktuara të KPK dhe KPA kanë ndikuar në disa raste në nxitjen e kritikave ndaj vettingut, në përgjithësi, si një proces që jo gjithnjë arrin të kualifikojë apo shkualifikojë kandidatin e duhur. Diskutime të tilla hasen sa herë që jepen vendime për emra të njohur, për të cilët ka një perceptim të përgjithshëm, qoftë ky pozitiv apo negativ.

Seancat e intervistave për kandidatët e SPAK-ut kanë bërë që në media volumi më i madh i raportimeve të mos jetë i fokusuar kryesisht te veprimtaria e KPK dhe KPA, por tek KLP. Ky është një ndryshim kahu i nisur që në tremujorin e dytë, i cili rrjedh nga konsolidimi i institucioneve të tjera që përbëjnë reformën, krahas KPK-së.

Duke përjashtuar gjysmën e parë të muajit korrik, e cila u karakterizua nga një përplasje e fortë mes kreut të shtetit dhe mazhorancës mbi Reformën në Drejtësi, periudha tjetër është karakterizuar nga një monitorim më së shumti teknik mbi zhvillimet që kanë të bëjnë me reformën.

Raportimi mbi Reformën në Drejtësi vijon të mbetet një sfidë për median dhe gazetarët shqiptarë për shkak të ndryshimeve thelbësore që ndodhën në të gjithë Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri, megjithatë gjatë kësaj periudhe vërehet një përmirësim i ndjeshëm në këtë drejtim. Konstatohet një përvetësim prej gazetarëve i temave për të cilat ata raportojnë. Ndryshe nga periudhat e mëparshme ka një përmirësim të dukshëm në këtë drejtim, edhe te portalet. Përmirësimi në këtë drejtim vjen kryesisht prej faktit se mediat e përzgjedhura si kampion kanë gazetarë të dedikuar që ndjekin nga afër zhvillimet që kanë të bëjnë me Reformën në Drejtësi.

Një ndër perceptimet që haset më shpesh lidhet me qëllimin e Reformës në Drejtësi, lidhet me parjen e saj si një ndryshim thelbësor në shërbim të burgosjes së zyrtarëve të lartë që janë të korruptuar. Një perceptim i tillë vjen edhe për shkak të diskursit të përdorur në publik nga zyrtarë të lartë apo përfaqësues diplomatik, por edhe prej nevojës së qytetarëve për të parë se drejtësia funksionon edhe për funksionarët e lartë të këtij vendi, të cilat janë parë si të “paprekshëm”.

Gjithashtu ky perceptim shoqërohet edhe me “bastin” se do të jetë fati i disa dosjeve të politikanëve të rëndësishëm që do të vulosë përfundimisht perceptimin nëse ishte apo jo e suksesshme.

*Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).*



Norwegian Embassy



**PARTNERS**ALBANIA  
FOR CHANGE AND DEVELOPMENT